



PËR NJË DREJTËSI PA VONESA

Historiku i projektit

Në dhjetor 2012, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri botoi raportin e monitorimit të çështjeve gjyqësore “Drejt Drejtësisë”, që mbështetj në vëzhgimin e proceseve civile në katër gjykata të rretheve gjyqësore. Raporti identifikoi një sërë problemesh në drejtimit të efektshmërisë, transparencës dhe aksesit në drejtësi. Një nga të dhënat domethënëse të monitorimit ishte se, nga 143 seanca gjyqësore të vëzhguara, 47,7% ishin tërësisht joproduktive. Ky numër i lartë i seancave joproduktive ndikoi që për çdo gjykim të zhvilloheshin mesatarisht 10,5 seanca. Në raportin “Drejt Drejtësisë”, Prezenca e OSBE-së formuloi 58 rekomandime për të rritur efikasitetin e proceseve civile, shumë prej të cilave mund të zbatohen lehtësisht brenda kuadrit aktual ligjor.

Në vijim të Konferencës së Liderit në Gjyqësor, në maj 2013, programi JuST i USAID-it, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Kryetarja e Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Krujë ranë dakord që të bashkëpunonin për një projekt pilot, me qëllim rritjen e aksesit dhe efikasitetit të gjyqësorisë, duke u përqendruar veçanërisht te forcimi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Brenda një viti, gjyqtaret e kësaj gjykate arritën të përfundojnë gati 86% të çështjeve në respektim të afateve standard të gjyqësorisë të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Numri mesatar i seancave u reduktua dukshëm. Pas këtyre rezultateve, Programi JuST i USAID-it dhe Prezenca e OSBE-së e shtrinë projektin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila, brenda 6 muajve, uli numrin mesatar të seancave gjyqësore, duke reduktuar në mënyrë drastike volumin e seancave joproduktive. Më 2015, gjykatave të Krujës dhe Korçës ju bashkuan ato të rretheve gjyqësore Pukë dhe Tropojë.

Projekti “Për një Drejtësi pa Vonesa” nisi të zbatohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë në shkurt 2015.


Studimi i të dhënave

Për të kuptuar më shumë ecurinë e çështjeve gjyqësore përpara zbatimit të projektit “Për një drejtësi pa vonesa”, në qershor 2015, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë u krye studimi i disa dosjeve gjyqësore, për të cilat ishte dhënë një vendim gjatë vitit 2014.

Qëllimi i këtij studimi ishte mbledhja e një sërë treguesish mbi proceset gjyqësore në këtë gjykatë, për të evidentuar kohëzgjatjen e proceseve dhe efikasitetin e seancave gjyqësore përpara zbatimit të Projektit, si dhe arsytet e shtyrjes së këtyre seancave. Këto të dhëna u përdoren si pikë referimi për evidentimin e rezultateve përfundimtare në Tropojë. U shqyrtuan 50 dosje gjyqësore, 23 të çështjeve civile dhe 27 të atyre penale. Për të kuptuar shkaqet e ndonjë vonesa të panevojshme në proces, janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme kategori të ndryshme çështjesh, nisur nga dy kritereve kryesore: çështjet e shqyrtuara duhet të ishin kryesisht çështje themeli, me palë, si dhe të përfunduara gjatë vitit 2014, pra, përpara nisjes së projektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Nga studimi i kryer rezultoi gjithashtu se përqindja e përgjithshme e seancave joproduktive në Tropojë ishte e lartë. Për çështjet civile ajo ishte 40%, shifër kjo e krahasueshme me atë të paraqitur në raportin “Drejt Drejtësisë” (47.7%). Për çështjet penale përqindja e seancave joproduktive ishte 38%.

Të dhënat fillestare



“PËR NJË DREJTËSI PA VONESA” NË TROPOJË

Në 10 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, bashkë me trupën gjyqësore dhe stafin administrativ, me praninë e organizatave ndërkombëtare dhe autoriteteve të larta të gjyqësorit, organizuan një takim me përfaqësuesit e institucioneve vendore për të nisur “Për një drejtësi pa vonesa”. Pak muaj më vonë, në korrik 2015, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së dhe USAID-it, u zhvillua një seminar dyditor me të gjithë gjyqtarët dhe kancelarin e gjykatës, për të reflektuar mbi të dhënat e mbledhura në Gjykatën e Tropojës. Në këtë takim u identifikuan disa rrugëzgjidhje për të ulur vonesat e panevojshme dhe për të përmirësuar shërbimet për qytetarët. Në bazë të diskutimeve të shumta, u hartua një plan i detajuar veprimesh. Ky plan, i miratuar nga gjykata, përfshin disa objektiva specifike për të shmangur seancat joproduktive dhe vonesat e panevojshme.



Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me institucionet vendore, korrik 2015.

Veprimtaria e Gjykatës

- Kancelari i Gjykatës ndërgjegjësoi palët që kërkesëpaditë të jenë të shoqëruara me provat e nevojshme.
- Kancelari kërkoi nga pala paditëse plotësimin e formularit me të dhënat përkatëse, duke mos pranuar paditë e pashoqëruara nga ky formular.
- U përmirësua procedura e njoftimit, duke përdorur mjete si, telefoni dhe posta elektronike.
- U ndërgjegjësuam palët për të njoftuar njëra-tjetrën për shtyrjen e seancës për shkaqe të arsyeshme.
- Gjyqtarët përmirësuan zhvillimin e seancave përgatitore, duke caktuar ekspertët ose dëshmitarët e nevojshëm që në këtë seancë, duke shmangur seancat joproduktive.

Veprimtaria e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor

Në bashkëpunim me Prokurorinë, u arrit që:

- Prokurori të jetë i pranishëm në çdo seancë gjyqësore;
- Dosja hetimore të ketë bashkangjitur një listë me emrin e të pandehurit dhe dëshmitarëve, adresat e sakta dhe të plota të tyre, si dhe çdo mundësi tjetër njoftimi;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë pati një angazhim maksimal në marrjen e masave për njoftimin dhe paraqitjen në gjykim të provave të kërkuara prej saj;
- Në gjykimin e shkurtuar, prokurori ishte gati t'i japë gjykatës aktet të cilat nuk ndodhen në dosjen hetimore, si dhe të japë konkluzionet përfundimtare që në seancën e parë (vetëm në raste të justifikuar).

Veprimtaria e Avokatëve

Nga avokatët u arrit që:

- Avokati të jetë i pranishëm në çdo seancë;
- Të mos paraqesë kërkesë shtyrje të padokumentuar me prova shkresore;
- Të paraqesë provat që në seancën e parë, duke ia bërë me dije edhe palës tjetër, përpara seancës;
- Të përmbushë, brenda datës së seancës së radhës, çdo detyrë që i ka lënë gjykata.
- Në çështjet penale, avokati, në të shumtën e rasteve, të paraqesë konkluzionet përfundimtare në të njëjtën seancë me prokurorin ose seancën e radhës.

Veprimtaria e Institucioneve Vendore

Institucionet vendore të Tropojës bënë të mundur:

- Dërgimin e përfaqësuesve në çdo gjykim;
- Kthimin e përgjigjes brenda seancës së radhës për çdo informacioni apo prova të kërkuara nga palët;
- Dhënien e informacionit ose provave palëve ose, në të kundërt, dhënien me shkrim të shkakut të refuzimit;
- T'i përgjigjen me korrektësi dhe brenda afatit shkresë të dërguar nga gjykata.

Veprimtaria e Komisarariatit të Policisë

Komisariati i Policisë Tropojë bëri të mundur:

- Njoftimin e të pandehurit dhe dëshmitarit para zhvillimit të seancës gjyqësore ose dërgimin në gjykatë të raportit përkatës të shërbimit për mosekzekutimin e këtij njoftimi.
- Shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarit, brenda afatit të dhënë, sa herë që iu kërkua nga gjykata.
- Kthimin e përgjigjes me shkrim për çdo informacion që kërkohet nga gjykata, brenda seancës së radhës.

Veprimtaria e Ekspertëve

Nga ana e ekspertëve, kur ka pasur të tillë në gjykim, u bë e mundur që:







- Eksperti të jetë i pranishëm në çdo seancë, kur i është kërkuar nga gjykata;
- Akti i ekspertimit të depozitohet në gjykatë përpara seancës së radhës dhe kopje të tij t'u vihen në dispozicion palëve përpara seancës.

Veprimtaria e Zyrës Postare

Zyra Postare Tropojë bëri të mundur:

- Njoftimin përpara zhvillimit të seancës;
- Që bashkëngjitur fletëthirrjes dhe provave të palës paditëse të jetë dhe formulari i kontaktit për palën e paditur ose palën e tretë, që kthehet i plotësuar në gjykatë bashkë me fletëthirrjen e nënshkruar.

REZULTATET E PROJEKTIT



“PËR NJË DREJTËSI PA VONESA” mbështetet nga këta partnerë:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Shkurt 2016

*Kjo fletë informuese u realizua me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.
Brendia e saj nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e kësaj organizate.*